



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:087538

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06615362

KA.nr.331/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Light Kosova” ShPK me NUI 810820739 dhe me seli në Veternik në Prishtinë, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson avokati Zeqir Fetoshi me seli në rrugën Bedri Berisha nr. 342, hyrja B, kati I/15-1 në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, objekt i kontestit anulimi i aktit administrativ, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 02.10.2024, në të cilën përfaqësuesit e të dy palëve, më 2 dhjetor 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Light Kosova” ShPK me NUI 810820739 kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.294/20 të datës 12.06.2020 e të së paditurit.
- II. Mbetet në fuqi aktvendimi A.nr. 1228/2020 i datës 27.07.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, i vërtetuar përmes aktvendimit AA.nr. 517/2020 të Gjykatës së Apelit, derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 23.07.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit, me kërkesë për anulimin e vendimit PSH.nr.294/20 të datës 12.06.2020 (numër i protokollit 394/20 i datës 24.06.2020) të së Paditurit dhe kthimin e çështjes në rivendosje.
2. Paditësi në padi e ka sqaruar rrjedhën e procedurës administrative në aktivitetin e prokurimit si dhe ka pretenduar se vendimi i goditur është joprofesional për faktin se nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe nuk është mbështetur në dëshmi apo fakte konkrete. Sipas tij, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë NTP Te Seli në

lidhje me këtë tender ka qenë i papërgjegjshëm për faktin se pronar i kësaj kompanie në këtë aktivitet të prokurimi ka ofertuar edhe me një kompani tjetër, konkretisht Hamiti Group ShPK, pronar i së cilës është ai, që nënkupton se z. S.H. ka ofertuar me dy kompani në këtë tender. Në këtë drejtim ka shtuar se ky veprim është në kundërshtim me pikën 7 të formularit të tenderit, i cili gjendet në çdo dosje të tenderit.

3. Më tutje ka shtuar se, ky pretendimin gjen mbështetje në interpretimin e KRPP-së tek pyetja me numër 27, ku specifikohet se nëse ndodh që një pronar ka dorëzuar më shumë se një tender në emër të kompanive, pronar i të cilave është, atëherë autoriteti kontraktues ka të drejtë ta refuzoj tenderin në bazë të pikës 7 të formularit të tenderit. Për fund ka shtuar se vendimi i goditur është kundërligjor, sepse ofertimi në këtë mënyrë dëmton konkurrencën dhe është konflikt interesi, madje shpi edhe në marrëveshje të fshehta të cilat e determinojnë fituesin dhe dëmtojnë buxhetin e autoriteteve kontraktuese, si dhe paraqet ndikim të paligjshëm sipas paragrafit 13 të nenit 130 të LPP-së.
4. I Padituri përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar padinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë. Ai ka pretenduar se, pretendimet Paditësi për shkelje të nenit 27.5 të RUOPP-së nuk janë të qëndrueshme dhe se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një operator ekonomik që ka ofertuar si tenderues individual dhe në të njëjtën kohë si anëtar i ndonjë grupi, por kemi të bëjmë me dy operator të ndryshëm të rekomanduara për lote të ndryshme dhe kanë emra të ndryshme të biznesit, më saktësisht janë dy subjekte të ndryshme juridike. Sipas tij, kjo nuk është e ndaluar me LPP dhe legjislacionin dytësor, andaj ka vërtetuar njoftimin për dhënien e kontratës, i cili ka vlerësuar që autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 60 të LPP duke e rekomanduar për kontratë tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi PSH.nr.294/20 i datës 12.06.2020 i të paditurit; raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën me numër 294/20, përpiluar nga H.M. dhe dorëzuar më 26.05.2020; ankesa e paditësit drejtuar ë paditurit më 12.05.2020 në aktivitetin e prokurimit konkret; vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nr. prot. ZP-10/20 i datës 30.04.2020 i Shërbimit Korrektues të pKosovës;

kërkesa për rishqyrtim dorëzuar nga paditësi më 28.04.2020 për Shërbimin Korrektues të Kosovës në aktivitetin e prokurimit konkret; kopja online nga ARBK e lidhur me shoqërinë tregtare S.H. B.I me NUI 811258070; kopja online nga ARBK e lidhur me shoqërinë tregtare Hamiti Group ShPK me NUI 811337501; njoftimi mbi vendimin e AK i datës 23.04.2020 i dhënë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në aktivitetin e prokurimit me numër 33600-19-9618-1-1-1; pjesa C: Formular për dorëzimin e tenderit, i paplotësuar nga askush (si shabllon).

6. Gjykata e pati të pamundshme t'i administroj provat e marrura në procedurën administrative, siç parasheh neni 43 para. 1 i LKA-së, meqenëse se i Padituri nuk i ka dorëzuar shkresat e lëndës administrative, ndonëse si në aktvendimin për në përgjigje në padi ashtu edhe në aktvendimin e veçantë ishte i obliguar nga kjo gjykatë që t'i sjell ato duke e paralajmëruar për pasojat nga neni 37 para. 3 i LKA-së.
7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. Paditësi kishte paraqitur tender në aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me material elektrik, hidrosanitarë, mjetet të punës dhe pajisjes tjera përcjellëse Lot1", me numër të prokurimit 33600-19-9618-1-1 të Shërbimit Korrektues të Kosovës si autoritet kontraktues (këtu e tutje AK). Këto fakte gjykata i vërtetoi nga vendimi i goditur.
9. Në aktivitetin e cekur më lart, mes tjerëve, kishin paraqitur tender edhe "NTP te Seli" (S.H. BI) me NUI811258070 dhe grupi i operatorëve ekonomik "Hamiti Group" ShPK me NUI 811337501 & A.H. BI. Pronar dhe person i autorizuar i NTP te Seli është S.H., ndërsa te "Hamiti Group" ShPK pronar i 100% të aksioneve dhe person i autorizuar është gjithashtu S.H. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të goditur dhe kopjeve online të regjistrit të ARBK lidhur me këto shoqëri tregtare.
10. Autoriteti kontraktues më 23.04.2020 kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin konkret të prokurimit, me të cilin e kishte njoftuar se i parë në listën ishte "NTP te Seli", paditësi i dyti, ndërsa "Hamiti Group ShPK & A.F. BI" ishte radhitur i treti. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes njoftimit të sapo cekur.
11. Më 28.04.2020 Paditësi kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim, ndërsa AK përmes vendimit nr. prot. ZP-10/2020 të datës 30.04.2020 e kishte refuzuar kërkesën për

rishqyrtim. Këto fakte gjykata i vërtetoi nga kërkesë për rishqyrtim dhe vendimi i posa cekur.

12. Paditësi më 12.05.2020 me të njëjtat pretendime sikur para kësaj gjykate kishte ushtruar ankesën ndaj vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, të cilën i Padituri përmes vendimit të goditur PSH.nr. 294/2020 të datës 12.06.2020 e kishte refuzuar ankesën e Paditësit si dhe e kishte vërtetuar njoftimin për dhënien e kontratës të AK-së. I Padituri në procedurën administrative para tij kishte caktuar ekspertin e prokurimit, i cili kishte gjetur se për NTP te Seli dhe Hamiti Group ShPK është i njëjti pronar, rrjedhimisht ankesa e Paditësit duhet të aprovohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Pavarësisht këtij mendimi të ekspertit, i Padituri kishte arsyetuar se nuk ka të bëj me një operator ekonomik i cili ka dorëzuar tender si individ dhe në të njëjtën kohë si anëtar i grupit, mirëpo ka të bëj me dy operator ekonomik të ndryshëm të rekomanduar për kontratë për dy lote të ndryshme, me emra dhe numra të biznesit të ndryshëm. Këto fakte gjykata i vërtetoi nga ankesa e Paditësit, raporti i ekspertit shqyrtues në procedurën administrative dhe vendimit të goditur.
13. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

14. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht ajo duhet të refuzohet.
15. Gjykata vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me LPP. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së si dhe arsyetimi i tij i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së. Në këtë drejtim gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e Paditësit lidhur me arsyetimin e vendimit të goditur, meqenëse në të janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara në nenin 48, konkretisht ai është i qartë dhe nga ai mund të kuptohen arsyet pse është vendosur si në dispozitiv.

16. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjykata rikujton se i Padituri kishte konstatuar se “NTP te Seli” (S.H. BI) me NUI811258070 dhe “Hamiti Group” ShPK me NUI 811337501 janë dy subjekte të ndryshme. Këtë konstatim të gjendjes faktike e përkrah edhe kjo gjykatë, meqenëse të dyja paraqesin shoqëri tregtare me subjektivitet juridik të ndarë. Sipas nenit 48.3 të Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (këtu e tutje LShT), biznesi individual nuk është person juridik, që nënkupton se është shoqëri tregtare e personit, rrjedhimisht subjektiviteti i personit fizik dhe i biznesit individual përkatës është i njëjtë. Në anën tjetër, sipas nenit 75.1 të LShT-së shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët është vetvetiu bartëse e te drejtave dhe obligimeve të saj. Kjo nënkupton se, biznesi individual dhe personi fizik si pronar i tij e kanë të njëjtin subjektivitet juridik, pra juridikisht janë i njëjti person, ndërsa shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është subjekt juridik në vete në raport me aksionarët e vet.
17. Nga ky rregullim juridik rezulton se tenderues në aktivitetin konkret të tenderimit nuk kanë aplikuar subjektet e njëjta, por personi fizik si biznes individual [“NTP te Seli” (S.H. BI) me NUI811258070] dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar si subjekt i ndarë nga pronari [“Hamiti Group” ShPK me NUI 811337501], rrjedhimisht juridikisht nuk paraqesin të njëjtin person.
4. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. LPP në dispozitat e tij nuk ka paraparë asnjë ndalesë që në një aktivitet të prokurimit të paraqes tender biznesi individual dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, edhe nëse pronari i biznesit individual është aksionar dhe person i autorizuar të shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Në këtë kuptim, gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e Paditësit, se dispozita e nenit 65.1. parashohin ndalesën e tillë. Paragrafët 1 deri 4 të nenit 65.1 të LPP-së parashohin ndalesën për operatorët ekonomik që të marrin pjesë në aktivitetin e prokurimit, kur (i) ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; (ii) ka operatori ekonomik ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit, si dhe (iii) kur ka konflikt interesi, konkretisht kur paraqitet çdo situatë ku anëtarët e

personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, asnjëra nga këto situata nuk është shfaqur, gjegjësisht neni 65 i LPP-së nuk gjen zbatim në këtë rast.

5. Përveç kësaj, as pika 27.5 e RRUOP-së të datës 10.04.2019 e KRPP-së nuk gjen zbatim, meqenëse nuk kemi të bëjmë me situatën ku një operator ekonomik ka prezantuar një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit.
6. Ngjashëm edhe pika 7 formularit të tenderit nuk ka rëndësi juridike në këtë çështje. Përmes asaj pike tenderuesi i vetëm si dhe në konsorcium deklaroi se nuk është duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Siç u sqarua më lart, operatori ekonomik “NTP te Seli” (S.H. BI) me NUI811258070 si tenderues individual dhe “Hamiti Group” ShPK me NUI 811337501, si pjesë e konsorciumit, nuk janë i njëjti subjekt juridik, rrjedhimisht nuk bien ndesh me këtë deklaratë.
7. Gjykata i pati parasysh edhe pretendimet tjera të Paditësit, por gjeti se ato nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.
8. Prandaj, meqenëse procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i padituri i dytë ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i padituri i dytë e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsytim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor nga LPPA, LKA ose LPP për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e aktit administrativ të goditur.
9. Gjykata vendosi që të lë në fuqi aktvendimin A.nr.1228/2020 të datës 27.07.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, i vërtetuar përmes aktvendimit AA.nr.517/2020 të datës 15.09.2020 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, me të cilin është shtyrë aktiviteti i prokurimit, pasi për vlerësim të kësaj gjykate

ende ekzistojnë kushtet e gjetura me ata aktvendime, ndërsa ky aktgjykim ende nuk është bërë i formës së prerë.

10. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata duke u bazuar në nenet 13, para. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.331/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.